



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 154 Prot.

Tiranë, më 28.02.2017

V E N D I M

Nr. 41, datë 28/02/2017

"Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Bashkia Kamëz"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe nenit 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë "*Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 23, datë 29.01.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Kamëz"*",

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr.113, datë 13.10.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kamëz*", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr.13, datë 29.01.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil "*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Kamëz*", në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Kamëz, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Të kërkojë nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, që të rregullojë pasojat lidhur me punonjësit të cilët nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, për shkak se nuk plotësojnë nivelin arsimor, si më poshtë:

1. *****, "*Specialist në Sektorin e Infrastukturës dhe Investimeve*";

- | | |
|-----------|--|
| 3. ***** | “Specialist në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës”; |
| 4. ***** | “Përgjegjës i Sektorit të Sporteve”; |
| 5. ***** | “Specialiste në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës”; |
| 6. ***** | “Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore”; |
| 7. ***** | “Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore”; |
| 8. ***** | “Specialist i Shërbimeve Publike”; |
| 9. ***** | “Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit”; |
| 10. ***** | “Specialist Informacioni dhe pritjes (one stop Shop)”; |
| 11. ***** | “Specialist i Mirëmbajtjes së Rrjetit Informatik”. |

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë situatën e paligjshmërisë, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se, ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi janë me arsim të mesëm.
 - Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Kamëz.
1. Të kërkojë nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz, të fillojë procedurën për revokimin e akteve administrative, me anë të të cilave janë kryer emërimet në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që parashikojnë plotësimin e një pozicioni të lirë pune detyrimisht nëpërmjet një procedure të rregullt konkurimi si më poshtë:
- Revokimin e aktit administrativ nr. 132, datë 17.03.2014 për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Publike”.
 - Revokimin e aktit administrativ nr. 106, datë 17.03.2014 për emërimin e nëpunëses ***** në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Ndihmës Ekonomike”.
 - Revokimin e aktit administrativ nr. 104, datë 17.03.2014 për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”.

Rekomandohet njësia përgjegjëse që, vëndet e punës, “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Publike”; “Specialiste në Sektorin e Ndihmës Ekonomike”; “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”; (pranë Bashkisë Kamëz), t’i shpallë

vende të lira, për t'u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji dhe në koherencë me strukturën e re të institucionit.

2. Të kërkojë nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz që të revokojë aktin nr. 133 prot., datë 17.07.2014, “*Akti i deklaramit të statusit të punësimit*”, për punonjësin *****, si nëpunës civil në pozicionin e punës “*Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore*”, si akt i dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi punonjësi nuk plotëson kriterin arsimor për të qenë nëpunës civil (*arsimi i mesëm*), dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit. Pozicioni i punës “*Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore*” duhet të shpallet i lirë, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij.
3. Të kërkojë nga njësia përgjegjëse të nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit, “*Nëpunës civil*”, për **16** punonjësit, të cilët përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të cilët në mënyrë analitike dhe sipas pozicioneve renditen si më poshtë:

1. ***** “*Specialist në Sektorin e Koordinim-Zhvillimit*”;
2. ***** “*Specialist në Sektorin e Koordinim-Zhvillimit*”;
3. ***** “*Specialist kordinator për çështje Infrastukture*”;
4. ***** “*Specialist sporti në Sektorin e Arsimit dhe Sportit*”;
5. ***** “*Specialist kulture në Sektorin e Arsim-Kulturës*”;
6. ***** “*Specialist kulture në Sektorin e Arsim- Kulturës*”;
7. ***** ”*Specialiste në Drejtorinë Juridike*”;
8. ***** ”*Specialiste në Drejtorinë Juridike*”;
9. ***** “*Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore*”;
10. ***** “*Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore*”;
11. ***** “*Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore*”;
12. ***** “*Specialist i Mirëmbajtjes Elektrike*”;
13. ***** “*Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun*”;
14. ***** “*Specialist Auditit*”;
15. ***** “*Specialist Auditit*”;
16. ***** “*Specialiste Protokoll-Arkive*”.

4. a- Të kërkojë nga njësia përgjegjëse, të verifikojë statusin e punësimit dhe të vijojë procesin duke nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit në kategorinë ”nëpunës civilë në periudhë prove”, për **13** punonjës, të punësuar në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të cilët janë në kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të cilët në mënyrë analitike dhe sipas pozicioneve renditen si më poshtë:

1. ***** “*Specialist Sektori i Kontrollit të Zhvillimit*”;
2. ***** “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”;
3. ***** “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike*”;
4. ***** “*Specialist Kulture*”;
5. ***** “*Specialist Prokurimesh*”;
6. ***** “*Specialiste Prokurimesh*”;
7. ***** “*Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore*”;

- | | | |
|-----|-------|---|
| 8. | ***** | “Specialiste e Taksave dhe Tarifave Vendore”; |
| 9. | ***** | “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun”; |
| 10. | ***** | “Specialist Mirëmbajtje Rrjeti Informatik”; |
| 11. | ***** | “Specialiste Informacioni dhe pritjes”; |
| 12. | ***** | “Specialiste Informacioni dhe pritjes”; |
| 13. | ***** | “Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike”. |

Njësia përgjegjëse në përfundim të procesit të përmendur më sipër, duhet të marrë masat për të zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit në periudhë prove duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA); për caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj duhet të shprehet për konfirmimin, ose jo të nëpunësve civilë në periudhë prove.

b- Të kërkojë nga njësia përgjegjëse, marrjen e masave për të zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për nëpunësit në periudhë prove duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA); për caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj duhet të shprehet për konfirmimin, ose jo të nëpunësve civilë në periudhë prove, për punonjësit:

1. ***** “Specialist Urbanistike, Inxhinier Arkitekt”, nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit në këtë pozicion nga Komuna Paskuqan, aktualisht Njësia administrative Paskuqan,
2. ***** “Specialist i Urbanistikës, Specialist Hidro ”, nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit në këtë pozicion nga Komuna Paskuqan, aktualisht Njësia Administrative Paskuqan,
3. Njësia përgjegjëse duhet të analizojë, të ndajë dhe të përcaktojë drejt raportet e pozicioneve të punës për punonjësit *****, emëruar në pozicionin e punës me emërtesë “Zëdhënëse” dhe për punonjësen *****, emëruar në pozicionin e punës me emërtesë “Specialiste e Statistikës dhe Sekretares së Kryetarit”, me legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punësimit në shërbimin civil dhe pas kësaj të vazhdojë me procedurat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Me kalimin e afatit procedural, prej 60 ditësh Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të vendimit, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i

Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Kjo procedurë ka filluar me Vendimin nr.38, datë 01.04.2016, të Komisionerit, me anë të të cilës u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin e inspektuar në datën **11.04.2016** dhe i kërkoi personit përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, nëpunëses *****, dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, pasi u administrua dhe shqyrtua dokumentacioni rezultoi se :

Së pari: Në lidhje me rekomandimin e pikës 2 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.13, datë 29.01.2015, të Komisionerit, rezultoi si vijon:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka kërkuar ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për punonjësit e cituar në pikën 2 të pjesës urdhëruese të Vendimit nr.13, datë 29.01.2016 “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Bashkia Kamëz*”, për shkak se ato nuk plotësojnë kërkesat e përgjithshme e të posaçme për të punuar në pozicione të shërbimit civil sipas përcaktimeve të shkronjës “e” të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikës 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*”. Institucioni ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit si më poshtë:

1. Me Urdhrin nr.59, dt.01.03.2016, bazuar ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe Vendimin nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit punonjësit *****, për shkak se nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji.
2. Me Urdhrin nr.60, dt.01.03.2016, bazuar ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe Vendimin nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit punonjësit *****, për shkak se nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji.
3. Me Urdhrin nr.62, dt.01.03.2016, bazuar ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe Vendimin nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit punonjësit *****, për shkak se nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji.
4. Me Urdhrin nr.63, dt.01.03.2016, bazuar ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe Vendimin nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit punonjësit *****, për shkak se nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji.
5. Me Urdhrin nr.64, dt.01.03.2016, bazuar ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe Vendimin nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit punonjësit *****, për shkak se nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji.
6. Me Urdhrin nr.65, dt.01.03.2016, bazuar ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe Vendimin nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i

është ndërprerë marrëdhënia e punësimit punonjësit ******, për shkak se nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji.

7. Me Urdhrin nr.66, dt.01.03.2016, bazuar ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Vendimin nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit punonjësit ******, për shkak se nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji.
8. Me Urdhrin nr.61, dt.01.03.2016 bazuar ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Vendimin nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit punonjëses ******, për shkak se nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji.
9. Pozicionet e punës që mbanin punonjësit ****** dhe ******, janë shpallur të lira me vendimin nr.1377, dt.25.03.2016.
Punonjësi ****** mbahet në punë për të mirëmbajtur rrjetin informatik dhe kompjuterik deri në momentin e zëvendësimit të tij sipas përcaktimeve të nenit 22 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
Sipas listë prezencës për periudhën 01-31.03.2016 të Bashkisë Kamëz, protokolluar me nr.1544, datë 06.04.2016, rezulton se punonjësi ****** nuk ushtron detyrën e përgjegjësit të sektorit të sporteve, çka presupozon ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për këtë pozicion pune duke iu referuar dhe faktit që ky pozicion pune është shpallur i lirë sipas vendimit nr.1377, dt.25.03.2016.
Sa më sipër, përsa i përket rastit të punonjësit ******, rekomandimi i Komisionerit mbetet pjesërisht i zbatuar dhe do të jetë objekt i një verifikimi tjetër.

Së dyti: Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 3 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.13, datë 29.01.2015, të Komisionerit, rezultoi si vijon:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka kërkuar revokimin e akteve të emërimit për punonjësit: 1- ****** me detyrë “*Specialist në Sektorin e Shërbimeve Publike*”; 2- ****** me detyrë “*Specialiste në Sektorin e Ndihmës Ekonomike*” dhe 3- ****** me detyrë “*Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median*”, për arsye se marrëdhënia e punësimit ka filluar në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (pas fillimit të efekteve ligjore të ligjit të mësipërm, datë 26.02.2014). Me Vendimin nr.1377, datë 25.03.2015 të titullarit të institucionit, janë shpallur të lira për konkurim.

Në zbatim të Vendimit nr.13, dt.29.01.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është ndërprerë marrëdhënia e punës për punonjësit e mësipërm:

-Urdhri nr.114, datë 14.04.2016, i cili revokon aktin administrativ nr.132, dt.17.3.2014 që i përket punonjësit ******.

-Urdhri nr.113, datë 14.4.2016, i cili revokon aktin administrativ nr.104, dt.17.3.2014 që i përket punonjësit ******.

- Urdhri nr.115, datë 14.4.2016, i cili revokon aktin administrativ nr.106, dt.3.3.2014 që i përket punonjëses ******.

Së treti: Në lidhje me zbatimin e pikës 4 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.13, datë 29.01.2016, të Komisionerit, rezultoi se me urdhrin nr.242, dt.01.09.2015, punonjësi ****** është larguar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil dhe është emëruar në një pozicion tjetër, jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil (*inspektor i*

*polici së bashki*ke). Komisioneri në vendimin e tij ka kërkuar edhe revokimin e statusit të punësimit nr.133, datë 17.7.2014, për arsye se ky punonjës nuk plotëson kërkesat e përgjithshme e të posaçme për të punuar në pozicion të shërbimit civil sipas përcaktimeve të shkronjës “e” të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, e për rrjedhojë nuk duhet të përfitontë deklarin e statusit sipas përcaktimeve të nenit 67 të ligjit të mësipërm.

Me urdhrin nr.117, datë 15.4.2016 të titullarit të institucionit, bazuar në ligjin për shërbimin civil dhe rekomandimin e Vendimit nr.13, datë 29.01.2016 të Komisionerit është revokuar akti administrative nr.133, dt.17.7.2014 “Akti i deklarinimit të statusit të punësimit”, për punonjësin *****.

Së katërti: Në lidhje me zbatimin e pikës 5 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.13, datë 29.01.2015, të Komisionerit, rezultoi si vijon:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për punonjësit e cituar në pikën 5 të vendimit ka kërkuar deklarin e statusit të punësimit “nëpunës civil”, sepse ata përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Kamëz, bazuar në rekomandimin e mësipërm ka nxjerrë aktin e deklarinimit të statusit të punësimit për punonjësit:

1. ***** Akti nr.1365/3, dt.23.03.2014;
2. ***** Akti nr.1365, dt.23.03.2014;
3. ***** Akti nr.1365/1, dt.23.03.2014;
4. ***** Akti nr.1365/2, dt.23.03.2014;
5. ***** Akti nr.4, dt.17.07.2014;
6. ***** Akti nr.47, dt.17.7.2014;
7. ***** Akti nr.44, dt.17.07.2014;
8. ***** Akti nr.43, dt.17.07.2014;
9. ***** me aktin nr.2802, dt.09.09.2015, ka përfunduar marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil për shkak të kërkesë nr.2772, dt.09.09.2015 “Dorëheqje nga detyra”;
10. *****me aktin nr.7, dt.01.09.2015 emërohet “Arkëtar” pranë Drejtorisë së Ujësjetllësit, pozicion që nuk përfshihet në shërbimin civil;
11. ***** me aktin nr.346, dt.2.10.2015, ka përfunduar marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil për shkak të kërkesë nr.3150, dt.01.10.2015 “Dorëheqje nga detyra”;
12. ***** me aktin nr.395, dt.05.10.2015, është larguar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit;
13. ***** është larguar nga detyra në datë 31.12.2015, në përfundim të afatit të kontratës nr.2694/4, dt.03.09.2015.
14. ***** me aktin nr.53, dt.02.03.2015, është larguar nga detyra. Nga përmbajtja e aktit administrativ, shkak i largimit të punonjësës është bërë me kërkesë të saj;
15. ***** me aktin nr.109, dt.01.03.2015 emërohet inspektor i IVMT-së, pozicion që nuk përfshihet në shërbimin civil;
16. ***** me aktin nr.443, dt.11.12.2015 është pezulluar nga detyra.(Shkak i daljes së aktit të pezullimit për këtë punonjësë nuk është cituar në aktin përkatës e për rrjedhojë mbetet për t’u verifikuar në një periudhë të mëvonshme).

Procedurat e kryera për sistemimin e nëpunësve: *****, **, *, **, **, në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Kamëz, në pozicione pune që nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, nga pikëpamja ligjore kanë parregullsi, sepse janë bërë në shkelje të kërkesave ligjore të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”, të ndryshuar. Por, fakti që nëpunësit nuk e kanë kundërshtuar aktin e transferimit, duhet të konsiderohet si pranim i marrëdhënies së re të punës me veprime konkludente.

Ndërsa për nëpunësit: *****, ***, ***, dhe *****, *****, të cilët e kanë ndërprerë marrëdhënien e punësimit për shkak të dorëheqjes, konsiderohet si heqje dorë vullnetarisht nga statusi i punësimit.

Për më tepër nëpunësit e mësipërm në momentin që ka dalë Vendimi nr.13, dt.29.01.2013 i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kanë qenë të larguar nga detyra për shkak të dorëheqjes, ose ishin emëruar në pozicione pune, të cilat nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Së pesti: Në lidhje me zbatimin e pikës 6/a të pjesës urdhëruese të vendimit nr.13, datë 29.01.2015, të Komisionerit, rezultoi se me shkresën nr.1254, dt.16.03.2016 i është kërkuar Shkollës së Administratës Publike (ASP), kryerja e ciklit të detyrueshëm të trajnimit për gjithë nëpunësit e cituar në pikën 6/a të vendimit të Komisionerit, sipas përcaktimeve të nenit 24 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, procedurë e cila mbetet për t’u verifikuar në një moment të dytë dhe konkretisht:

1. ***** Specialist në Sektorin e Kontrollit dhe Zhvillimit;
2. ***** Specialist i Ndhmës Ekonomike;
3. ***** Specialiste e Ndhmës Ekonomike;
4. ***** Specialist Prokurimesh në Drejtorinë Juridike;
5. ***** Specialiste Prokurimesh në Drejtorinë Juridike;
6. ***** Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore;
7. ***** Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median;
8. ***** Specialiste Informacioni;
9. ***** Përgjegjës i Sektorit të Ndhmës Ekonomike.

Njësinë e burimeve njerëzore e Bashkisë Kamëz na bëri me dije se pozicioni i punës “specialiste e informacionit dhe pritjes one stop shop” që i përket punonjësës ***** dhe pozicioni i punës “specialist kulture” që i përket punonjësit ***** nuk hyn në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, sipas përcaktimeve të pikës “c” të nenit 4 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Për më tepër punonjësi ***** nuk vazhdon më marrëdhënien e punës me Bashkinë Kamëz. (Listë prezencë për periudhën 01-31/03/2016)

Arrihet në këtë përfundim, nisur nga detyrat që kryejnë këta punonjës. Sipas përcaktimeve të pikës “d” të nenit 4 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ato nuk ushtrojnë funksione publike, por veprimtari administrative shërbimi.

Procedura e kryer për emërimin e punonjësës ***** me anë të Urdhrit nr.276, datë 01.12.2014 në një pozicion pune që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, nga pikëpamja ligjore ka parregullsi, sepse është bërë në shkelje të kërkesave ligjore të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”, të ndryshuar. Por, fakti që nëpunësja nuk e ka kundërshtuar aktin e mësipërm, duhet të konsiderohet si pranim i marrëdhënies së re të punës me veprime konkludente.

Ndërsa për nëpunësin *****, i cili e ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit për shkak të dorëheqjes, konsiderohet si heqje dorë vullnetarisht nga statusi i punësimit.

Përsa i përket pikës 6/b, në respektim të rekomandimit të Komisionerit, ka dalë akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 11/2, dt.05.01.2015 për nëpunësin ***** dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.11/3, dt.05.01.2015 për nëpunësin *****, si nëpunës civil në periudhë prove. Edhe për këto nëpunës me shkresën e mësipërme është kërkuar kryerja e ciklit të detyrueshëm të trajnimit.

Së gjashti: Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve në pikën 7 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.13, datë 29.01.2015, të Komisionerit, rezultoi si vijon:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka konstatuar se për punonjësen *****, pozicioni i punës ku është emëruar ka emërtesën “Zëdhënëse”, e cila nuk parashikohet nga neni 19 i ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si pozicion në shërbimin civil. Sipas parashikimeve të nenit 4, pika”ç”, të ligjit të mësipërm, emërtesa “zëdhënës”, përfshihet si pjesë e kabinetit të titullarit të institucionit.

Në interpretim të nenit 2, të ligjit të mësipërm, pozicionet që kryejnë detyra të cilat në kuptim të ligjit janë “funksionarë kabinetit”, janë të përjashtuar nga fusha e veprimit të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në zbatim të rekomandimit të Komisionerit, me Urdhrin nr.27, datë 05.01.2016, punonjësja ***** është emëruar “Specialiste”, emërtesë dhe pozicion që parashikohet nga neni 19 i ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në rastin konkret, pozicioni i sipërcituar, është përfshirë në organigramën e institucionit, si pozicioni i cili është pjesë e shërbimit civil dhe është trajtuar nga njësia përgjegjëse si i tillë.

Përsa i përket zbatimit të rekomandimit në lidhje me rregullimin e pozicionit “Specialiste e Statistikës dhe Sekretare e Kryetarit” për punonjësen *****, në raport me legjislacionin që rregullon marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil, nga ana e njësisë përgjegjëse nuk ishte vepruar me pretendimin se do të rregullohet, kur të miratohet struktura e bashkisë Kamëz për vitin 2017. Pra, kjo pjesë e rekomandimit të pikës 7 të vendimit të Komisionerit mbetet e pazbatuar.

Mbetet për t’u verifikuar më vonë, përcaktimi i saktë i pozicionit të punës për emërtesën e mësipërme, “Specialiste e Statistikës” duke e ndarë nga pozicioni i sekretares.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 13, datë 29.01.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Kamëz”, është zbatuar nga ana e subjektit, **Bashkia Kamëz**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Bashkia Kamëz.
- 2.** Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr. 13, datë 29.01.2015 ,*“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Kamëz”*.
- 3.** Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Kamëz dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA